

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8314
E premte, 5 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Opozita është dashur t'i bojkotojë zgjedhjet! | **FAQE 5**



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

RRUGA DREJT SIGURISË ENERGETIKE DHE PARTNERITETIT AFATGJATË ME AMERIKËN



FAQE 4-5

Shkruan: Anu PRATTIPATI, e ngarkuar me punë në Ambasadën e ShBA-së

GAZI AMERIKAN SI TEST I POLITIKËS ENERGETIKE TË KOSOVËS



Kosova vazhdon të mbetet vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor i papërfshirë në projektet që zgjerojnë ndikimin energjetik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rajon. Në prag të zgjed-

hjeve të parakohshme parlamentare, të cilat mbahen më 7 qershor në Kosovë, çështja e furnizimit të mundshëm me gaz të lëngshëm natyror (LNG) nga ShBA-ja ka marrë vëmendje të shtuar

HAMZA PARAQET ZOTIMIN PËR ARSIMIN: DIGJITALIZIM, RINIA NË QENDËR DHE FOND BURSASH NË VLERË PREJ 30 MILIONË EUROSH

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@ml.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

AKTUALE



DHOMA E PËRFAQËSUESVE MIRATON MASËN PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS NË IRAN | **F. 2**

PARAQITET ECURIA E HARTIMIT TË MASTERPLANIT PËR KOMPLEKSIN MEMORIAL "ADEM JASHARI" NË PREKAZ | **F. 7**

RUBIO: ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË NATO TANI NUK ËSHTË NË KRYE TË AGJENDËS SË ALEATËVE | **F. 3**

EKONOMI



DELEGACIONI I BOK-së TAKOHET ME DELEGACIONIN E FMN-së, TAKIMI U FOKUSUA NË ZHVILLIMET GLOBALE FINANCIARE DHE MAKROEKONOMIKE | **F. 8**

LULZIM RAFUNA RIZGJEDHET NË KRYE TË ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS | **F. 5**

SPORT



CAS KONFIRMON VENDIMIN E FFK-së NË RASTIN E ANKESËS SË FC PRISHTINËS | **F. 11**

DHOMA E PËRFAQËSUESVE MIRATON MASËN PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS NË IRAN

WASHINGTON, 4 QERSHOR - Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ka miratuar rezolutën për kompetencat e luftës që synon ta frenojë fushatën ushtarake të presidentit amerikan Donald Trump kundër Iranit, teksa sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, insistoi se operacionet amerikane ndaj Teheranit kanë përfunduar.

Dhoma e miratoi rezolutën me 215 vota për dhe 208 kundër më 3 qershor, me katër republikanë që iu bashkuan të gjithë demokratëve në mbështetje të rezolutës, raporton REL.

Rezoluta, që është paraqitur nga përfaqësuesi nga Nju-Jorku, Gregory Meeks, udhëzon Trumpin që t'i largojë forcat e armatosura amerikane nga armiqësitë me Iranin, përveç nëse Kongresi zyrtarisht shpall luftë apo autorizon përdorimin e forcës.

Kjo masë tani dërgohet në Senat, ku ligjvënësit po shqyrtojnë një rezolutë të ndarë për kompetencat e luftës. Edhe nëse miratohet nga dy dhomat e Kongresit, Trumpi pritet t'i sfidojë përpjekjet për ta kufizuar autoritetin e tij dhe masa e Dhomës së Përfaqësuesve gjerësisht shihet si simbolike sepse nuk e ka fuqinë detyruese ligjore.

Votimi dypartiak sinjalizon rritjen e kundërshtimit në Kongres

Ky votim shënoi kundërshtimin më të fortë të Kongresit deri më tani ndaj konfliktit, i cili ka zgjatur për më shumë se tre

muaj dhe ka nxitur shqetësime për pasojat e tij ekonomike dhe gjeopolitike.

Përmes një deklarate pas votimit, Meeks argumentoi se fushata ushtarake nuk kishte arritur objektivat e saj të shpallura dhe, përkundrazi, sipas tij, kishte dëmtuar përpjekjet diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me programin bërthamor të Iranit. "Nëse ka bërë diçka, ajo e ka larguar edhe më shumë mundësinë e një zgjidhjeje diplomatike për programin bërthamor të Iranit", tha ai.

Demokrati nga Nju-Jorku vuri në pah rritjen e çmimeve të karburanteve dhe koston financiare të konfliktit, duke thënë se amerikanët po paguanin dukshëm më shumë për benzinën, ndërsa njëkohësisht po mbanin barrën e shpenzimeve të një lufte që shumë prej tyre e kundërshtojnë.

Udhëheqësit demokratë në Dhomën e Përfaqësuesve i përsëritën këto shqetësime, duke argumentuar se konflikti binte ndesh me premtimet elektorale të Trumpit për t'i shmangur luftërat jashtë vendit dhe për t'i ulur kostot për familjet amerikane.

Megjithatë, udhëheqësit republikanë këmbëngulën se fushata ushtarake nuk përbënte një luftë që kërkonte autorizim nga Kongresi dhe paralajmëruan se kufizimi i autoritetit të presidentit mund të shkonte në favor të udhëheqjes iraniane. Megjithatë, kundërshtimi brenda radhëve republikane është shtuar. Përfaqësuesit Thomas Massie nga Kentaki,



Brian Fitzpatrick nga Pensilvania, Tom Barrett nga Miçigani dhe Warren Davidson nga Ohajo u shkëputën nga qëndrimi i shumicës së partisë së tyre për ta mbështetur këtë masë.

Rubio mbron strategjinë e administratës

Disa orë para votimit në Dhomën e Përfaqësuesve, sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, mbrojtë mënyrën se si administrata e ka menaxhuar konfliktin gjatë një seance dëgjimore para Komitetit për Punët e Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve. "Ne nuk po kryejmë më sulme të vazhdueshme brenda Iranit për të dobësuar kapacitetet e tij ushtarake, sepse operacioni Tërbimi Epik ka përfunduar", tha Rubio, duke iu referuar fushatës ushtarake amerikane. Ai shtoi se Uashingtoni i kishte arritur objektivat e tij.

Rubio argumentoi se synimi i administratës nuk kishte qenë

kurrë ndryshimi i regjimit në Teheran. "Ne do të donim të shihnim një ndryshim në Iran dhe që ai të qeverisej nga populli, por ky nuk ishte qëllimi i misionit tonë", tha Rubio para ligjvënësve. Sekretari i Shtetit tha se ShBA-ja synon ta eliminojë aftësinë e Iranit për ta kërcënuar rajonin me sulme në shkallë të gjerë me raketa dhe dronë, duke argumentuar se kjo aftësi do ta zvogëlonte ndikimin ndërkombëtar mbi ambicet bërthamore të Teheranit.

Lehtësimi i sanksioneve i lidhur me lëshimet bërthamore

Rubio tha, po ashtu, se çdo lehtësim i sanksioneve amerikane ndaj Iranit do të varet nga lëshimet që Teherani do të bëjë lidhur me programin e tij bërthamor. "Ata nuk do të përfitojnë asnjë lloj lehtësimi të sanksioneve, përveç nëse heqin dorë nga pasurimi i uranimit dhe eliminojnë rezervat e uranimit të pasuruar në nivele të

larta", u tha ai ligjvënësve. Sipas Rubios, diskutimet ndërmjet Uashingtonit dhe Teheranit po vazhdojnë të përqendrohen në kornizën e negociatave të ardhshme. Ai tha se Irani ka treguar më shumë gatishmëri për të diskutuar për çështjen e pasurimit të uranimit sesa në bisedimet e mëparshme, por ende nuk ka marrë zotime që përmbushin kërkesat e ShBA-së. "Disa muaj më parë ata refuzonin të diskutonin për çështjet e pasurimit të uranimit dhe të uranimit të pasuruar në nivele të larta", tha Rubio. "Mendoj se tani, në disa nga dokumentet që janë shkëmbyer mes palëve, këto çështje trajtohen qartë, por ende nuk kemi miratimin përfundimtar nga sistemi i tyre, të paktën deri në mëngjesin e sotëm [3 qershor]".

Rubio shtoi se Shtetet e Bashkuara do ta shqyrtonin heqjen e bllokadës së tyre detare vetëm nëse Irani rikthen lirinë e lundrimin nëpër Ngushticën e Hormuzit.

Administrata amerikane ka argumentuar se konflikti në fakt përfundoi pasi Trumpi urdhëroi një armëpushim në fillim të prillit. Shtëpia e Bardhë e ka hedhur poshtë gjithashtu rezolutën e Dhomës së Përfaqësuesve, duke e cilësuar si një përpjekje jokushtetuese për të kufizuar autoritetin ekzekutiv, duke thënë se aktualisht nuk ka më armiqësi aktive nga të cilat forcat amerikane duhet të tërhiqen.

Senati ende nuk ka caktuar ndonjë datë për një votim përfundimtar për rezolutën e tij të veçantë mbi kompetencat e luftës.

SHTETET E BE-së KËRKOJNË RREGULLA MË TË ASHPRA PËR REFUZIMIN E VIZAVE TURISTIKE PËR RUSËT

BRUKSEL, 4 QERSHOR - Një numër shtetesh anëtare të Bashkimit Evropian po i bëjnë trysni Komisionit Evropian ta sjellë një legjislacion, i cili do ta bënte më të lehtë refuzimin e vizave turistike për qytetarët rusë, për shkak të pushtimit të plotë të Ukrainës nga Moskë.

Suedia do ta paraqesë këtë çështje për diskutim - me mbështetjen e Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Letonisë, Lituaniës dhe Holandës, si dhe të vendeve të zonës Shengen që nuk janë pjesë e BE-së, Islandës dhe Norvegjisë - kur ministrat e Brendshëm të bllokut të mbledhen në Luksemburg për takimin e tyre të rregullt mujor më 4 qershor.

Para takimit, këto vende i

dërguan një letër Komisionit Evropian ku shprehën shqetësimet e tyre.

Sipas tekstit, të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë (REL), është "thellësisht shqetësuese të shohësh një numër në rritje turistësh rusë që shijojnë pushimet në plazhet dhe resortet evropiane, ndërkohë që raketat dhe dronët vazhdojnë t'i godasin civilët dhe infrastrukturën civile në Ukrainë". "Kjo është edhe më e dhimbshme duke pasur parasysh se mijëra fëmijë ukrainas të dëbuar në mënyrë të paligjshme dhe të dërguar me forcë nuk mund të kthehen te familjet e tyre", thuhet në tekst.

Kjo çështje po shtrohet në një kohë kur statistikat e BE-së, të cilat i ka parë REL-i, tregojnë një



rritje të numrit të vizave turistike të zonës Shengen të lëshuara për rusët gjatë vitit 2025, duke arritur në gati 480.000.

Ky është numri më i lartë që nga nisja e pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia në vitin

2022.

Nuk pritet që legjislacioni i ri të miratohet menjëherë, dhe kjo do të thotë se nuk ka gjasa të ketë ndryshime para sezonit veror, kur lëshohet shumica e vizave turistike.

Në vend të kësaj, shpresohet që

një propozim të paraqitet më vonë gjatë këtij viti dhe të miratohet në vitin 2027.

Megjithatë, kjo nuk do të jetë aspak e lehtë.

Tri shtetet e BE-së që lëshojnë më së shumti viza turistike për rusët janë Franca, Italia dhe Spanja. Në këto vende turizmi kontribuon ndjeshëm në ekonominë kombëtare.

Megjithëse një ligj i mundshëm i BE-së kërkon vetëm shumicë të thjeshtë, pra 55 për qind të shteteve anëtare që përfaqësojnë 65 për qind të popullsisë së përgjithshme të bllokut, pesha e madhe e këtyre tri vendeve së bashku do të thotë se atyre u nevojitet vetëm edhe një shtet tjetër anëtar për ta bllokuar çfarëdo mase të propozuar.

RUBIO: ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË NATO TANI NUK ËSHTË NË KRYE TË AGJENDËS SË ALEATËVE



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, tha se zgjerimi i NATO-s për ta përfshirë Kosovën aktualisht nuk është në krye të agjendës së aleatëve, por shtoi se kjo nuk do të thotë se një gjë e tillë nuk mund të ndodhë në të ardhmen.

Gjatë një seance dëgjimore në Komitetin për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, Rubio tha se Shtetet e Bashkuara mbështesin kandidatin italian për postin e ri të përfaqësuesit të lartë në Bosnjë-Hercegovinë, duke thënë se besojnë se ai "do ta kryente mirë punën dhe do të ndihmonte në sjelljen e stabilitetit në këtë funksion".

Sekretari amerikan i Shtetit iu përgjigj pyetjeve të kryetarit të Nënkomitetit për Evropë në Dhomën e Përfaqësuesve, Keith Self, i cili së fundmi ka vizituar Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë dhe Kosovën. Gjatë seancës, Self

e cilësoi situatën në Ballkanin Perëndimor si "jashtëzakonisht të brishtë".

Self tha se mes Serbisë dhe Kosovës ekziston një "problem i pazgjidhur" dhe i kërkoi Rubios që, në bisedimet me katër vendet anëtare të NATO-s që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe që, rrjedhimisht, e bllokojnë anëtarësimin e saj në aleancën ushtarake perëndimore, të mbështesë anëtarësimin e Kosovës në NATO.

Rubio tha se, bazuar në takimet e tij me ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të aleancës, NATO-ja "është e përqendruar në çështje të tjera" dhe se "zgjerimi, posaçërisht në rastin e Kosovës, por edhe në raste të tjera, nuk është në krye të agjendës së këtyre vendeve". Megjithatë, ai shtoi se kjo "nuk do të thotë se një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë". "Kjo nuk ka pasur vend të rëndësishëm në

bisedimet e fundit me aleatët tanë të NATO-s", tha Rubio.

Kosova synon të bëhet pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian. Por, shtetet që nuk e njohin pavarësinë e saj, të shpallur më 2008, vazhdojnë të jenë pengesë në integrimin euroatlantik të Prishtinës. Self, së bashku me dy kolegë të tij në Kongres, Ritchie Torres dhe Mike Lawler, ka paraqitur në Dhomën e Përfaqësuesve një rezolutë në mbështetje të anëtarësimin të Kosovës në NATO. Në këtë rezolutë thuhet se prania e Kosovës në aleancë është e domosdoshme për mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare të ShBA-së në Evropën Juglindore.

"Zotëria nga Italia" për Bosnjë-Hercegovinën

I pyetur nga Self për zgjedhjen e përfaqësuesit të ri të lartë në

Bosnjë-Hercegovinë, pas dorëheqjes së Christian Schmidtit, Rubio tha se ShBA-ja mbështet "zotërinë nga Italia", pa e përmendur emrin e tij. Diplomati italian Antonio Zanardi Landi përmendet si kandidat që gëzon mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, ndërsa vendet evropiane kanë kandidatët e tyre. "Përtej kësaj, ne mbetemi të angazhuar në këtë çështje, siç e theksuat edhe ju, dhe këtë e kemi bërë edhe privatisht. Gjëja e fundit që duam të shohim është çfarëdo lloj konflikti atje, çfarëdo ndarjeje, kufizimi apo gjëra të kësaj natyre që do të shkaktonin konflikt të mëtejshëm", tha Rubio.

Në Sarajevë, të mërkurën, nisi mbledhja e Këshillit për Zbatimin e Paqes (PIC), në të cilën pritet të diskutohet për zgjedhjen e përfaqësuesit të ri të lartë në Bosnje e Hercegovinë, si dhe për përcaktimin e mandatit të tij të

ardhshëm.

Përveç Zanardit, ndër kandidatët e përmendur janë edhe i dërguari i posaçëm i Francës për Ballkanin Perëndimor, René Troccaz, si dhe të dërguarit aktualë dhe të mëparshëm britanikë për Ballkanin Perëndimor, Karen Pierce dhe Stuart Peach.

Nëse nuk arrihet marrëveshje, përfaqësuesi aktual i lartë, Schmidt, do të mbetet në detyrë deri në një vendim tjetër, siç ka paralajmëruar edhe vetë gjatë dorëheqjes së tij.

Përfaqësuesi i lartë, i cili emërohet nga PIC-u, ka mandat për ta mbikëqyrur zbatimin civil të Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit, me të cilën, më 1995, u ndal lufta në Bosnjë-Hercegovinë. Atij i janë dhënë të ashtuquajturat kompetenca të Bonit, që përfshijnë mundësinë e imponimit të vendimeve dhe ligjeve, si dhe shkarkimin e zyrtarëve në Bosnjë-Hercegovinë.

PARAQITET ECURIA E HARTIMIT TË MASTERPLANIT PËR KOMPLEKSION MEMORIAL "ADEM JASHARI" NË PREKAZ



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në prezantimin e ecurisë për hartimin e masterplanit për Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

Duke e vlerësuar këtë si njërin nga projektet më të rëndësishme të Republikës së Kosovës për kujtesën historike, për trashëgiminë kulturore dhe për identitetin tonë, kryeministri në detyrë Kurti tha se Prekazi zë një vend të posaçëm në kujtesën historike të

popullit tonë. "Qëndresa dhe sakrificat e familjes Jashari e shndërruan atë në simbol të mbrojtjes së ndheut dhe të përkushtimit ndaj lirisë, duke dëshmuar kështu se liria nuk është vetëm ideal politik, por edhe vlerë për të cilën flijohet gjithçka", tha ai.

Kryeministri në detyrë theksoi se trajtimi i Komplexit Memorial "Adem Jashari" nuk është vetëm një projekt i planifikimit hapësinor, i konservimit apo i muzealizimit, por një detyrim institucional për ta ruajtur, dokumentuar dhe përcjellë me

dinjitet këtë trashëgimi te brezat që vijnë pas nesh.

Pas prezantimit të ecurisë, kryeministri në detyrë, Kurti, tha se, sipas planifikimit të paraparë, gjatë këtij viti pritet të përfundojnë projektet e konservimit të Kullave të Rezistencës, ndërsa shtoi se kjo do t'i mundësojë Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit që t'i iniciojë procedurat e prokurimit për zbatimin e këtyre projekteve, duke shënuar kalimin nga faza e planifikimit dhe projektimit në fazën e ndërhyrjeve konkrete konservuese në terren.



HAMZA PARAQET ZOTIMIN PËR ARSIMIN: DIGJITALIZIM, RINIA NË QENDËR DHE FOND BURSASH NË VLERË PREJ 30 MILIONË EUROSH

Kryetari i PDK-së dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka paraqitur të enjten zotimin e katërt të programit qeverisës, të fokusuar në reformimin dhe modernizimin e sistemit arsimor. Hamza në një konferencë për medie ka thënë se një sistem arsimor cilësor aftëson qytetarë, ndërton ekonomi konkurruese dhe institucione të qëndrueshme prandaj, sipas tij, qeveria e udhëhequr nga PDK-ja do ta trajtojë këtë sektor si prioritet kombëtar

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Kryetari dhe kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka paraqitur zotimin e katërt të programit të tij qeverisës për reformim dhe modernizim të sistemit arsimor, aftësi për të ardhmen dhe mundësi për të rinjtë Hamza në një konferencë për medie tha se një sistem arsimor cilësor aftëson qytetarë, ndërton ekonomi konkurruese dhe institucione të qëndrueshme prandaj, sipas tij, qeveria e udhëhequr nga

PDK-ja do ta trajtojë këtë sektor si prioritet kombëtar. "Arsimi nuk është shpenzim. Arsimi është investimi më i sigurt që një shtet mund të bëjë për të ardhmen e vet. Prandaj, më 7 qershor, ne kërkojmë besimin e qytetarëve për të ndërtuar një sistem arsimor modern, cilësor dhe konkurrues, që u jep fëmijëve dhe të rinjve tanë njohuritë, aftësitë dhe mundësitë që meritojnë. Sepse ndryshimi i Kosovës fillon me edukimin e brezit që do ta ndërtojë Kosovën e së nesërme", ka thënë kryetari i PDK-së. Hamza duke përmendur sfidat me të cilat ballafaqohen

mësimdhënësit dhe nxënësit e studentët, ka treguar se në qendër të vizionit të tij për arsimin është rinia e Kosovës. Ai premtoi fond të bursave prej 30 milionësh euro në vit dhe programe studimi që garantojnë mundësi punësimi, që të rinjtë ndërtojnë jetën dhe karrierën e tyre në Kosovë. "Qeveria e PDK-së do të forcojë autonominë universitare, do të mbështesë kërkimin shkencor dhe do të zgjerojë bashkëpunimin ndërkombëtar me universitetet më prestigjioze evropiane dhe botërore. Ne duam universitete që jo vetëm japin diploma, por prodhojnë dije,

inovacion dhe zgjidhje për zhvillimin e vendit. Në këtë drejtim, do ta themelojmë edhe Fondin e Bursave për Studentët. Për herë të parë do të krijojmë Fondin e Bursave për Studentët me vlerë prej 30 milionë euro në vit. Ky fond do të garantojë mbështetje të drejtpërdrejtë për studentët, pavarësisht gjendjes së tyre ekonomike apo sociale. Investimi në studentët tanë është investim në kapitalin më të çmuar të Kosovës, në qytetarët e saj. Rrafsh tjetër ku do të fokusohemi është edhe arsimi joformal dhe kreativiteti rinor", premtoi Hamza, duke shtuar se një nga prioritetet e PDK-së është edhe modernizimi i arsimit profesional dhe lidhja e tij e drejtpërdrejtë me nevojat e ekonomisë. "Shkollat profesionale do të pajisen me infrastrukturë moderne, ndërsa bizneset do të përfshihen aktivisht në procesin e edukimit praktik të nxënësve. Qëllimi ynë është i qartë: më shumë aftësi

profesionale, më shumë vende pune dhe më shumë mundësi për të rinjtë që të ndërtojnë karrierën e tyre në Kosovë", tha Hamza.

Po ashtu, lideri i PDK-së falënderoi mijëra qytetarë anëmbanë Kosovës që deri më sot kanë shprehur mbështetje për PDK-në dhe i ftoi të gjithë në tubimin përmbyllës në Prishtinë të shtunën. "Kudo që kemi qenë, kemi ndjerë energjinë e qytetarëve për ndryshim. Kemi ndjerë dëshirën e tyre për t'i dhënë fund krizës, për të rikthyer shpresën dhe për të ndërtuar një Kosovë me më shumë mundësi për të gjithë. Prandaj, sot dua t'i ftoj të gjithë qytetarët që të na bashkohen në tubimin tonë përmbyllës, të shtunën, më 6 qershor, nga ora 20:00, në sheshin 'Skënderbeu' në Prishtinë. Le ta përmbyllim së bashku këtë rrugëtim me një mesazh të qartë: Kosova meriton më shumë. Dhe, Kosova do të ndryshojë. Do ta ndryshojmë ne", tha Hamza.

OPOZITA ËSHTË DASHUR T'I BOJKOTOJË ZGJEDHJET!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Fuqia e parasë përcaktues për rezultat: Është hera e tretë që këmbëngul që opozita ka gabuar shumë që po merr pjesë në zgjedhje. Sidomos pasi Kurthi ndau 200 milionë euro si "ndihma për zbutje të inflacionit" si dhe 2 milionë euro për bileta aeroplani për diasporën nga data 1 qershor 2026 e tutje. Edhe kjo është ekskluzivisht për blerje të votave. Prenotimi i biletave të autobusit për diasporën ka filluar menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve, në mënyrë të organizuar dhe me para të bizneseve të pushtetit, oligarkëve të Kurthit, tenderëve njëburimorë dhe parave të pista të Martin Strujës, me vëllanë nga biznesi - Vuk Hamović. Albin Kurthi nuk ka lënë mjet pa përdorur për të ardhur në pushtet, nuk lë gjë pa bërë për të qëndruar në pushtet! Ka emëruar në këtë kohë militantë partiakë në poste të larta institucionale, ka kapur të

gjitha bordet, KGJK, KPK, AKI, diplomacinë, mediat, institucionet e pavarura etj. Ka ushtruar dhunë të paparë ndaj mediave të pavarura, ka dhunuar vendimet e GJK kur nuk ishin në favor të tij. Ka linçuar dhe kërcënuar publikisht Blerim Isufajn duke e dhunuar konkursin publik. E do prokurorin dhe prokurorin personale, diktatori! E ka shtrirë për toke ASHAK-un dhe tash po përpiqet ta ringjallë duke e bërë "akademikun e kanalizimeve" Agim Bahtirin - paqurkën në krye të kësaj akademie. Brutalisht ka sulmuar UÇK-në, luftëtarët e lirisë, familjet emblematike Jashari dhe Haradinaj, ka dhunuar të drejtat e të burgosurve politikë, ka qenë mik i Gjykatës Speciale Raciste në Hagë kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit. Duke e luftuar patriotizmin dhe patriotët, duke e luftuar Bacë Adem Demaçin përmes marginalizimit, ka favorizuar filoserbët dhe neojugosllavët. Merreni listën e kandidatëve të propozuar nga LV-ja për deputetë; nuk gjeni as 10 përqind që kanë kontribuar personalisht dhe familjarisht për shqiptarët, Kosovën dhe shqiptarinë, pjesa tjetër kanë qenë në anën antikombëtare. Ose, merreni kabinetin qeveritar, aty nuk ka patriotë, ka të tillë që e kanë trashëguar

patriotizmin por që po sillen për faqe të zezë! Më përgënjeshtroi me fake, urdhëroni. Në këto rrethana është e pamundur të mundet me vota Albin Kurthi sepse i ka paratë e shtetit kurse opozita nuk ka asgjë. Albini i blenë votat, bashkë me ndonjë deputet të opozitës, nëse i duhet. Në çastin kur Kurthi i ka ndarë mbi 200 milionë euro për blerje të votave, opozita është dashur të deklarohet publikisht se nuk merr pjesë në zgjedhje të blera dhe menjëherë është dashur të fillojë me organizimin e protestave. Sa ta ketë Kurthi kuletën e shtetit të cilën e keqpërdorë si në "bahçe të babës" opozita nuk ka çka të kërkojë në zgjedhje sepse rezultati është paracaktuar. Në rrethana normale Kurthi nuk do fitonte as 40 deputetë, në rrethana të korrupsionit endemik të votuesve, Kurthi e vazhdon diktaturën. Opozitë thujta nuk ka sepse as që mendojnë të bëjnë opozitë e që e lehtëson brutalitetin kurthian kundër çdo kundërshtari real dhe imagjinar. Opozita nuk mendon që të bashkohet edhe nëse i bënë votat. Në LDK janë dy persona që duan të rehatohen, Abdixhiku dhe Osmani, i pari si KM i Bangladeshit, e dyta si presidente e Kurveleshit. Ky

është qëllimi i tyre, jo bërja e opozitës, jo detronizimi i Kurthit. Abdixhiku kurrë nuk është ndjerë LDK-ja, Vojsa Osmani ishte xhelate e LDK-së. Po të kishte fuqinë e Albin Kurthit, Vojsa Osmani është 100 herë më e keqe se Kurthi! PDK-ja po mbështetet në elefantë politikë, ka mbetur pa rini vepruese. AAK-ja ka potencial të kufizuar politik (7- 8 deputetë) por ka potencial të madh për protesta. Pas zgjedhjeve opozita nuk ka të drejtë të ankohej, ka pranuar rregullat e lojës të Kurthit. Realisht, Abdixhiku dhe Vojsa Osmani lehtësisht i bashkohen Kurthit pas zgjedhjeve. E patë se si u sollën ndaj Përparim Ramës pasi bëri koalicion me PDK-në në Prishtinë. U distancuan nga Rama. Për t'i pëlqyer Kurthit. Vojsa Osmani, xhelatja e LDK-së e kërcënoi Kurthin se pas zgjedhjeve i ka vetëm dy mundësi; ose ta bëjë përsëri presidente, ose ta bëjë këtë me komandantët e PDK-së duke e përmendur shprehimisht emrin e Sami Lushtakut. Çfarë shantazhimi brutal dhe i turpshëm i një të deklasuare që nuk ka guxuar të garojë vet por i ka lëshuar vezët e qyqes në follenë e LDK-së. Këta nuk bëjnë koalicion me krahun e luftës por bëjnë koalicion me krahun prej jugosllav dhe

antikombëtarë të LV-së. Këta e sulmojnë Përparim Ramën shkaku se ia kanë frikën karizmës së Ramës. Aktualisht, Përparim Rama është personi më karizmatik në Kosovë dhe i vetmi person që mund ta bëjë bashkë opozitën. Rezultatet e mia preliminare dje janë të projektuara për një trup votues 800.000 deri 850.000 votues të vlefshëm.

A është Zoran Xhinxhiqi martiri i radhës i LV-së: Antikombëtarja Fitore Pacolli - Subvencija dje përdhosi brutalisht emrin, kujtimin dhe veprën e patriotit të madh, Isa Boletini duke e binjakëzuar me ideologun antishqiptar, Zoran Xhinxhiq. Çfarë turpi dhe poshtërsie! Sot i ndanë, merreni me mend. Çka dallon Fitore Pacolli nga Gashi, Gjinovci dhe Xhymshiti? Asgjë, janë të një brumi, antikombëtarë dhe filojugosllavë. Dje, Fitore Pacolli deshi ta ringjallë Boro dhe Ramizin përmes Zoran Xhinxhiqit dhe Isë Boletinit. Brutalisht e ulët. Sa e pamëshirshme është jeta, nga bashkimi hipotetik kombëtar deri të bashkimi real dhe konkret i Zoran Xhinxhiqit dhe Isa Boletinit. Ku jeni Albin Kurthi, Dejana Mihali, Lenka Quko, Glauk SHIKU, Kaloshi dhe Baloshi? Atdheu në rrezik! Nga trutharët dhe tradhtarët!

FSK-ja NË KONFERENCËN PRESTIGJIOZE TË NATO-s, ILIR RAMA NË MESIN E LIDERËVE TË LARTË TË NËNOFICERËVE

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Rreshteri major i Forcës së Sigurisë së Kosovës, OR9, Ilir Rama, po merr pjesë në Konferencën e 22-të Ndërkombëtare të Liderëve të Lartë të Nënoficerëve Senior (International Command Senior Enlisted Leader Conference - ICC 2026), e cila po mbahet në Shkollën e NATO-s në Oberammergau të Gjermanisë. Kjo Konferencë organizohet nga Komanda Aleate e NATO-s për Transformim (Allied Command Transformation - ACT) dhe mbledh Liderët e Lartë të Nënoficerëve nga struktura komanduese e NATO-s, strukturat e forcave të NATO-s,

vendet partnere, Byroja e Gardës Kombëtare të ShBA-së, programet e NATO-s dhe ShBA-së, si dhe përfaqësues të institucioneve arsimore ushtarake në NATO. Qëllimi i konferencës është të ofrojë një kuptim të qartë të mjedisit aktual gjeopolitik, sfidave të sigurisë dhe prioriteteve strategjike që ndikojnë në operacionet e NATO-s dhe vendeve partnere. Gjithashtu, ajo shërben si platformë për shkëmbimin e përvojave, identifikimin e mësimëve të nxjerra dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve aleate dhe



partnere. Fokusi i Konferencës "ICC 2026"

ishite ofrimi i një pasqyre të qartë mbi prioritetet aktuale

strategjike të NATO-s, situatën e sigurisë në mjedisin operacional, si dhe mësimet e identifikuar dhe të nxjerra nga aktivitetet dhe operacionet në zonat e përgjegjësisë dhe interesit të NATO-s, vendeve partnere, si dhe në rajone të tjera me rëndësi strategjike. Po ashtu gjatë punimeve të Konferencës "ICC2026" rreshteri major i FSK-së, ka takuar edhe homologët e tij nga vendet e NATO-s dhe vendeve partnere pjesëmarrëse në këtë konferencë si dhe ka paraqitur vizionin KOMFSK për zhvillimin e NOF në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Lulzim Rafuna rizgjedhet në krye të Odës Ekonomike të Kosovës

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës ka përmbyllur të enjten procesin zgjedhor të brendshëm. Kuvendi Zgjedhor ka rizgjedhur Lulzim Rafunën në pozitën e kryetarit edhe për një mandat të ri. Procesi zgjedhor u zhvillua në Prishtinë, me pjesëmarrjen e

delegatëve të Kuvendit, përfaqësues të komunitetit të biznesit nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit. Votimi u zhvillua në përputhje me procedurat demokratike dhe transparente të organizatës. Pas rizgjedhjes, kryetari Rafuna falënderoi anëtarësinë

për besimin e dhënë, duke theksuar se ky besim përbën përgjegjësi të madhe për vazhdimin e angazhimit në forcimin e rolit të OEK-së si zëri kryesor i komunitetit të biznesit në Kosovë. Ai u zotua se në mandatin e ri fokusi do të jetë në avancimin e dialogut me institucionet

vendore, përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe kontributin në përmirësimin e imazhit ekonomik të Republikës së Kosovës. Oda Ekonomike e Kosovës mbetet e përkushtuar në përfundimin dhe mbështetjen e bizneseve, me synim krijimin e një ambienti



më të favorshëm për zhvillim ekonomik dhe rritje të qëndrueshme.

GAZI AMERIKAN SI TEST I POLITIKËS ENERGETIKE TË KOSOVËS



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Kosova vazhdon të mbetet vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor i papërfshirë në projektet që zgjerojnë ndikimin energjetik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rajon.

Në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të cilat mbahen më 7 qershor në Kosovë, çështja e furnizimit të mundshëm me gaz të lëngshëm natyror (LNG) nga ShBA-ja ka marrë vëmendje të shtuar.

Vëzhguesit e zhvillimeve në Kosovë konsiderojnë se vendi është vonuar në këtë drejtim, dhe se furnizimi eventual me gazin e lëngshëm amerikan i krijon vendit siguri energjetike, e cila e përforcon edhe sigurinë kombëtare. Sipas tyre, për t'u bërë pjesë e zinxhirit të furnizimit me LNG nga ShBA-ja, kërkohet vullnet politik në Kosovë.

Përderisa Lëvizja Vetëvendosje (LV) në pushtet e vë më shumë theksin tek interesimi për "gazifikimin e qymyrit vendor", partitë e deritashme opozitare i thonë qartazi "po" gazit të lëngshëm amerikan.

Në vitin 2021 Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga LV-ja, refuzoi një projekt të mbështetur nga ShBA-ja, përmes Korporatës të Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC),

për t'u lidhur me rrjetin rajonal të gazit natyror, përmes Maqedonisë së Veriut.

Asokohe autoritetet qeveritare arsyetuan se "Kosovës i duhen më shumë informata për të qenë e sigurt se ndërtimi i infrastrukturës së gazit është opsioni më i mirë" për tranzicionin energjetik të vendit. Në periudhën e viteve 2018-2019, Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga Ramush Haradinaj, nxiti projektin e ndërtimit të një gazsjellësi Shkup - Prishtinë, që do ta lidhte Kosovën me rrjetin rajonal të gazit. Megjithatë, ai nuk u realizua.

LV-ja: Gazifikim i qymyrit vendës dhe bashkinvestim në terminalin e Vlorës

Në shkurt të 2026-s, në Samitin Trans-Atlantik për Sigurinë e Gazit, ministrja e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, tani në detyrë, kishte shprehur gatishmërinë e vendit për t'u furnizuar me gaz të lëngshëm natyror nga ShBA-ja. Por, Rizvanolli, nga radhët e LV-së - parti e cila ka qeverisur vendin në pesë vjetët e fundit - nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë se a ka partia e saj zotim konkret për ta bërë Kosovën

pjesë të zinxhirit të furnizimit me LNG nga ShBA-ja.

Kryeministri në detyrë, njëherësh udhëheqës i LV-së, Albin Kurti, tha në një intervistë për televizionin lokal Kanal10 se qeveria është e "interesuar për gazifikimin e qymyrit tonë që është në sipërfaqe".

Gazifikimi i qymyrit nënkupton procesin industrial ku qymyri shndërrohet në gaz të djegshëm, të quajtur gaz sintetik, i cili më pas mund të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike. "Këtë [gazifikimin e qymyrit] mund ta bëjmë me një kompani amerikane, për shembull", u shpreh Kurti. "E, në anën tjetër, jemi të interesuar që të bashkinvestojmë me Shqipërinë në terminalin në Vlorë", theksoi Kurti, ndërsa nuk saktësoi se cili do të ishte përfitimi i Kosovës nga një bashkinvestim i tillë dhe nëse Kosova do ta marrë gazin e lëngshëm amerikan.

Në maj të këtij viti kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, deklaroi se ka nënshkruar një marrëveshje strategjike bashkëpunimi për zhvillimin e Qendrës Energjetike të Vlorës dhe për furnizimin e Shqipërisë me gaz të lëngshëm natyror, në partneritet të ngushtë me ShBA-në. Sipas tij, Shqipëria do të furnizohet me gazin e lëngshëm

amerikan në 20 vjetët e ardhshëm.

PDK-ja: Gazi amerikan, projekt me rëndësi ekonomike dhe strategjike

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka nënvizuar se në rast se do të qeverisë pas zgjedhjeve të këtij muaji, do ta "lidhë Kosovën me gazin amerikan" dhe do t'i japë "fund varësisë nga importet e shtrenjta të energjisë".

Kandidati i PDK-së për deputet në Kuvendin e Kosovës, Arben Mustafa, thotë për Radion Evropë e Lirë se partia e tij zotohet t'i qaset menjëherë dhe me prioritet projektin që sjell gazin e lëngshëm amerikan në Kosovë. "Kosova ka nevojë që urgjentisht të ndërtojë kapacitete të reja energjetike. Një prej opsioneve më të mundshme sigurisht që është gazi amerikan. Për ne, ky projekt nuk ka vetëm rëndësi ekonomike, por ka edhe rëndësi strategjike", shprehet Mustafa.

Ai shton se futja e Kosovës në zinxhirin e furnizimit me LNG nga ShBA-ja i siguron vendit qëndrueshmëri dhe pavarësi energjetike, por edhe e rreshton atë në linjën e interesave të

aleatëve të saj. Mustafa pret që projekti për marrjen e gazit të lëngshëm amerikan të hartohet me partnerët e Kosovës, në radhë të parë me ShBA-në.

LDK-ja: Gazi amerikan zgjidh problemin e furnizimit me energji

Në rast se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) fiton zgjedhjet më 7 qershor, projekti i gazit të lëngshëm nga ShBA-ja do të realizohet pa asnjë dyshim nga qeveria e ardhshme, thonë nga kjo parti.

Kandidati i LDK-së për deputet, Avdullah Hoti, konsideron që është bërë dëm i madh për vendin që ky projekt nuk është realizuar deri më tani. "Do t'i mundësonte Kosovës që, në afat të mesëm, të zgjidhte në mënyrë të qëndrueshme problemin e furnizimit me energji. Parësore është ndërtimi i centralit energjetik me gaz, për të përmbushur kërkesën vendore për energji elektrike, ndërsa në fazën pasuese do të mundësohej zgjerimi i rrjetit të gazit për nevojat e industrisë dhe të ekonomisë në përgjithësi", thotë Hoti për Radion Evropë e Lirë. Sipas tij, projekti i gazit nuk është alternativë ndaj energjisë së

RRUGA DREJT SIGURISË ENERGJETIKE DHE PARTNERITETIT AFATGJATË ME AMERIKËN

Shkruan: Anu PRATTIPATI,
e ngarkuar me punë në
Ambasadën e ShBA-së

Kosova nuk po arrin t'i përmbushë kërkesat në rritje për furnizim me energji. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, në katër vitet e fundit Kosova ka shpenzuar 735 milionë euro në importimin e energjisë elektrike nga vendet fqinje, që shënon rritje nga 142 milionë euro në vitin 2024 në 259 milionë euro në vitin 2025. Në të ardhmen e parashikueshme, përderisa çmimi dhe kërkesat për energji vazhdojnë të rriten, Kosova do të varet gjithnjë e më shumë nga fqinjët e saj.

Për të adresuar këto sfida strukturore, Kosova do të duhej t'i bashkohej projekteve amerikane të gazit natyror të planifikuara nëpër Ballkan. Këto projekte mund të sigurojnë burime energjetike amerikane për Kosovën. Gazi natyror i lëngshëm amerikan (GNL) do të mundësonte shtimin e llojlojshmërisë në furnizimin me energji, do të plotësonte burimet e brendshme energjetike të Kosovës dhe do të përbënte edhe një lidhje tjetër në partneritetin ekonomik në rritje ndërmjet ShBA-së dhe Kosovës.



I Dërguari i Posaçëm i Departamentit të Energjisë së ShBA-së për Integrimin Energjetik, z. Xhoshua Volz, rishtazi shpjegoi: „Sistemi energjetik në Kosovë ka nevojë urgjente për modernizim dhe paraqet mundësi të shkëlqyeshme për industrinë dhe teknologjinë amerikane... dhe Departamenti i Energjisë do të jetë i gatshëm të ndihmojë në lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet industrisë amerikane dhe partnerëve industrialë në Kosovë”. Në botën e sotme, siguria

energjetike është siguri kombëtare, e llojlojshmëria e burimeve energjetike përmes gazit natyror është thelbësore për arritjen e të ardhmes së sigurt. Centralet elektrike me gaz natyror ofrojnë aftësinë për të përmbushur më mirë rritjen e kërkesës dhe për të stabilizuar çmimet gjatë periudhave të pikut. Zgjerimi i prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike përtej kërkesës së vendit do të përmirësonte pavarësinë energjetike dhe do t'i mbronte konsumatorët nga lëvizjet e papritura të çmimeve.

Kosova duhet të veprojë shpejt për të realizuar këtë partneritet sepse ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme do të kërkojë kohë. Eksportet e GNL -së amerikane pritet të dyfishohen deri në vitin 2030 dhe do të rrjedhin përmes projekteve rajonale si Korridori Vertikal i Gazit dhe terminali lundruer i gazit natyror në Kroaci. Kosova gjithashtu mund të lidhet me gazsjellësin që po ndërtohet për të lidhur terminalin e GNL -së në Aleksandrupolis në Greqi me Shkupin në Maqedoninë e Veriut.

Lidhja me një projekt gazsjellësi tashmë të planifikuar do të shkurtojte afatin kohor dhe do të ulte shpenzimet. Gjithashtu, Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka në dispozicion mekanizma financimi për të ndërtuar infrastrukturë të gazit natyror. Kosova mund të punojë me partnerët rajonalë për të siguruar kontrata afatgjata dhe ekonomike të shkallës me çmime me konkurrense. Mundësia për t'iu bashkuar këtyre projekteve po mbyllet. Vonesa e këtij vendimi rrezikon që furnizimet amerikane të GNL-së të zotohen diku tjetër dhe një gjë e tillë mund ta lërë Kosovën si vendin e vetëm në Ballkanin Perëndimor pa qasje në GNL-në amerikan. Historia nuk mund të qëndrojë në rrugë të vendimeve që do t'i sjellin përfitime popullit të Kosovës sot dhe në të ardhmen. Kosova tani përballet me një zgjedhje të rëndësishme strategjike. Administrata e presidentit Trump prioritet kryesor e ka uljen e varësisë së Evropës nga energjia ruse. Ne e nxisim Kosovën të hyjë në partneritet afatgjatë energjetik me Amerikën përmes GNL-së për të siguruar të ardhmen e saj energjetike. Së bashku, ne mund të forcojmë sigurinë energjetike dhe t'i risim ekonominë tona krahas për krahu.

ripërtërishme, por plotësues i saj, duke krijuar stabilitet në sistemin energjetik dhe duke e bërë më të lehtë integrimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtërishme.

Hoti pohon se modelet e financimit të projektit për sjelljen e gazit amerikan në Kosovë mbeten për t'u diskutuar, por duke pasur parasysh rëndësinë strategjike të sektorit të energjisë, ai shpreh bindjen se “financimi mund të sigurohet përmes një kombinimi të investimeve private, partneriteteve publiko-private dhe huamarrjes shtetërore me kushte të favorshme”.

Aleanca: Gazi amerikan, kusht për çdo bashkëqeverisje

Nga Aleanca, parti që së voni shkurtoi emrin nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), thonë se e kanë dëshmuar qysh herët vullnetin politik për ta sjellë gazin amerikan në Kosovë, duke iu referuar nismës së ish-kryetarit Ramush Haradinaj tetë vjet më parë.

Nënkryetari i Aleancës dhe kandidati i saj për deputet, Besnik Tahiri, thotë për Radion Evropa e Lirë se në programin e partisë

është përfshirja e këtij projekti strategjik, i cili, thekson ai, Kosovës i ofron siguri energjetike, kombëtare, si dhe forcon lidhjet me aleatin strategjik, SHBA-në. “Aleanca nuk do të hyjë në asnjë marrëveshje për të qeverisur, në asnjë rrethanë, në qoftë se nuk përfshihet taksativisht në programin qeveritar ndërtimi i centralit të gazit në Ferizaj, dhe kyçja e Kosovës në gypat e LNG-së, të cilat janë tanimë në shumicën e vendeve të rajonit”, shprehet Tahiri. Ai shton se investimet për projektin do të jenë publike dhe amerikane.

Siguria energjetike, siguri kombëtare

Njohësit e zhvillimeve që ndërlidhen me energjetikën në Kosovë vlerësojnë se SHBA-ja po bën përpjekje që t'i mos i lërë vendet e Ballkanit Perëndimor të cenueshme përballë ndikimit rus dhe ndikimeve tjera në sektorin e energjisë.

Ish-ministri i Energjetikës i Kosovës, Ethem Çeku, konsideron se gazi i lëngshëm amerikan është një nga alternativat që mund t'i sigurojë vendit sigurinë energjetike. “Zgjidhjen më të mirë e kemi duke përdorur gazin amerikan, të cilin qeveria e presidentit Trump



po e ofron për ta larguar Ballkanin nga ndikimi i Gazprom-it rus”, thotë Çeku për Radion Evropa e Lirë.

Ai thekson se nga furnizimi me gaz amerikan, Kosova do të kishte përfitime të dyanshme: përmes gazit prodhon energji elektrike, si dhe e kursen rrymën duke e përdorur gazin për industri, prodhim dhe amvisëri.

Siguria energjetike, sipas Çekut, do të krijojë edhe sigurinë ekonomike, e cila drejtpërdrejt ndikon edhe në sigurinë kombëtare.

Inkuadrimi në zinxhirin e furnizimit me gaz të lëngshëm nga SHBA-ja është vlerësuar të jetë me rëndësi për sigurinë kombëtare

edhe nga drejtori i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka.

Në një intervistë për REL-in, ditë të parë, ai tha se “siguria energjetike sot është siguri kombëtare” dhe se “këtë Kosova po dështon që ta kuptojë”.

Kosova deri më tash ka mbetur jashtë sistemit të ndërlidhjes në rrjetin që sjellë gazin amerikan në rajon, por këtë mund ta bëjë duke u ndërlidhur me Shqipërinë ose Maqedoninë e Veriut, thotë Çeku. “Unë do ta sugjeroja lidhjen përmes Shqipërisë - jo për shkak të natyrave politike - por ajo është një nga rajonet më të sigurta për lidhjen e mundshme, që Kosova të furnizohet me gaz. Ne, gjithashtu,

duhet ta kemi të ndërtuar ndonjë bllok me gaz [për prodhim të energjisë elektrike], i cili e bën të qëndrueshëm furnizimin me energji elektrike”, thekson ai.

Çeku shton se infrastruktura për të sjellë gazin e lëngshëm amerikan në Kosovë do të jetë e kushtueshme, sepse duhet ndërtuar nga fillimi. Por, sipas tij, çdo vonesë për ta realizuar një gjë të tillë, do të ketë kosto edhe më të lartë. “Ne, jo vetëm që jemi vonuar, por për çdo ditë që vonohemi për projektin e gazit të lëngshëm amerikan, do të humbim me qindra miliona [euro] në blerjen e energjisë elektrike, siç kemi blerë mbi 1 miliard euro energji elektrike”, shprehet ai.

GJYKATA SUPREME SQARON: KUSHTETUESJA NUK KA RRËZUAR VENDIMIN PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Gjykata Supreme e Kosovës ka dalë me një sqarim publik lidhur me raportimet në medie për vendimet gjyqësore që lidhen me tregun e lirë të energjisë elektrike. Sipas Gjykatës Supreme, disa raportime që pretendojnë se "Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar vendimin e Gjykatës Supreme për tregun e lirë të energjisë dhe e ka kthyer çështjen në rishqyrtim" nuk i referohen aktgjykimin për liberalizimin e tregut të energjisë. "Gjykata Supreme e Kosovës informon opinionin publik se raportimet sipas të cilave 'Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar vendimin e Gjykatës



Supreme për tregun e lirë të energjisë dhe e ka kthyer çështjen në rishqyrtim, nuk i referohen aktgjykimin të Gjykatës Supreme me të cilin ishte aprovuar padia

administrative e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike", thuhet në sqarim. Gjykata sqaron se vendimi i

Kushtetueses ka të bëjë me një çështje tjetër gjyqësore. "Për sqarim, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me një aktvendim tjetër të Gjykatës Supreme, përmes të cilit ishte hedhur poshtë si e palejueshme padia e një paditësi, me arsyetimin se akti i kontestuar nuk përmbante elementet e një akti nënligjor normativ dhe, rrjedhimisht, nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për shqyrtimin e tij në procedurë administrative", thuhet më tej.

Në sqarim përmendet edhe vendimi për të cilin Gjykata Supreme kishte vendosur në favor të Odës Ekonomike të Kosovës. "Me këtë aktgjykim, Gjykata

Supreme kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e OEK-së dhe kishte shpallur të paligjshëm dhe shfuqizuar nenin 8 të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, si dhe nenin 2 të Udhëzuesit për ndryshimin dhe plotësimin e tij", thuhet në komunikatë.

Gjykata thekson se ky vendim lidhet me çështje të veçanta juridike dhe nuk është objekt i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për të cilin është raportuar. "Për hir të informimit të drejtë, të saktë dhe të plotë të opinionit publik, ju ftojmë që ta publikoni këtë sqarim", përfundon njoftimi i Gjykatës Supreme.

KGS DHE CEO SH. P. K. FORMALIZOJNË PARTNERITET STRATEGJIK PËR FUQIZIMIN E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK DHE INVESTIMEVE

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Komuniteti i Bizneseve Kosovaro-Gjermano-Zvicerane (KGS) dhe CEO Sh. P. K. kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, duke shënuar fillimin e një partneriteti strategjik të orientuar drejt fuqizimit të lidhjeve ekonomike ndërmjet Kosovës, diasporës shqiptare dhe komunitetit ndërkombëtar të biznesit.

Ky partneritet synon të krijojë mundësi të reja për investime, bashkëpunim ekonomik, shkëmbim përvojash dhe zhvillim të rrjeteve profesionale, duke shfrytëzuar potencialin e madh të bizneseve shqiptare në Kosovë, Gjermani, Zvicër dhe më gjerë.

Në kuadër të marrëveshjes, palët do të bashkëpunojnë për organizimin dhe promovimin e forumeve ekonomike, panairove, konferencave, takimeve B2B dhe aktiviteteve të tjera që synojnë krijimin e urave të reja të bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat, investitorëve dhe institucioneve relevante.

Gjithashtu, bizneset anëtare të KGS-së do të kenë qasje në mundësi të zgjeruara promovimi, rrjetëzimi dhe pjesëmarrjeje në ngjarje me rëndësi ekonomike në Kosovë dhe rajon.

Presidenti i KGS-së, Shkelzen Jusaj, theksoi se ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm në misionin e



organizatës për ta afruar diasporën me mundësitë ekonomike në Kosovë dhe për të krijuar partneritete të qëndrueshme që kontribuojnë në

zhvillimin ekonomik të vendit. Ndërkaq, drejtori i CEO Sh. P. K., Bekim Xhafa, vlerësoi se bashkëpunimi me KGS do të ndihmojë në zgjerimin e rrjetit të

partnerëve strategjikë dhe në krijimin e platformave konkrete që lidhin bizneset, investitorët dhe profesionistët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit.

KGS përfaqëson një rrjet të rëndësishëm biznesesh shqiptare në Kosovë, Gjermani dhe Zvicër, ndërsa CEO Sh. P. K. është ndër organizatorët kryesorë të forumeve, panairove dhe ngjarjeve ekonomike në Kosovë dhe rajon. Përmes këtij memorandum, të dy organizatat riafirmojnë angazhimin e tyre për të kontribuar në rritjen e investimeve, promovimin e sipërmarrjes dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim ekonomik afatgjatë.

DELEGACIONI I BQK-së DHE AI I FMN-së FLASIN PËR ZHVILLIMET GLOBALE FINANCIARE DHE MAKROEKONOMIKE

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Delegacioni i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), i udhëhequr nga guvernatori Ahmet Ismaili dhe i përbërë nga zëvendësguvernatorët Milot Cakaj dhe Nesrin Shileku-Shala, u takua me delegacionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Delegacioni i FMN-së u udhëhoq nga Tobias Adrian, kryekëshilltar financiar dhe drejtor i Departamentit të Tregjeve Monetare dhe të Kapitalit dhe përbëhej nga Yigit Yasar, drejtor ekzekutiv në FMN, Mark Horton, zëvendësdrejtor i Departamentit Evropian të FMN-së dhe Hajdari Korbi.



Në takim mori pjesë edhe ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, i cili diskutoi politikën e stabilitetit makrofinanciar dhe zhvillimet

aktuale makroekonomike. Takimi u fokusua në zhvillimet globale financiare dhe makroekonomike si dhe ndikimin e tyre në ekonominë e

vogla dhe të hapura, me theks të veçantë në rëndësinë e stabilitetit financiar, politikave të kujdesshme, mbikëqyrjes efektive dhe qëndrueshmërisë institucionale në adresimin e rreziqeve të reja dhe pasigurive. Palët diskutuan edhe për prioritetet strategjike të BQK-së, bashkëpunimin e vazhdueshëm me FMN-në dhe rolin e asistencës teknike në mbështetjen e reformave në fusha kyçe, përfshirë stabilitetin financiar, mbikëqyrjen bankare, politikën makroprudenciale, qeverisjen institucionale, sistemet e pagesave, financat digjitale dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen e BQK-së për mbështetjen e vazhdueshme të FMN-së dhe theksoi rëndësinë e partneritetit strategjik ndërmjet FMN-së dhe BQK-së për avancimin e reformave, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit financiar të Kosovës.

BQK-ja ritheksoi përkushtimin për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me FMN-në, në përputhje me mandatin e saj për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe avancimin e modernizimit të sektorit financiar sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

ASK-ja: Vazhdon rritja e çmimeve të pronave të banimit

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Pronave të Banimit (IÇPB) për tremujorin e parë (TM1) 2026, me vitin bazë 2018 = 100. Indeksi i Çmimeve të Pronave

të Banimit (IÇPB) në Kosovë u rrit 5,3 % në tremujorin e parë (TM1) 2026 krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2025. Ndërkaq, krahasuar me tremujorin e katërt (TM4) 2025, çmimet e pronave të banimit shënuan rritje prej 2,4 %.

Në rajonin e Prishtinës çmimet e pronave të banimit u rritën me 1,4 % në tremujorin e parë 2026 krahasuar me tremujorin e parë 2025. Në rajonet e tjera të vendit çmimet e pronave të banimit u rritën për 12,3 % në tremujorin

e parë 2026 krahasuar me tremujorin e parë 2025. ASK-ja ka njoftuar se të dhënat për TM4 2025 janë rishikuar pas pranimit të të dhënave të reja dhe përditësimit të bazës së të dhënave administrative, duke theksuar se vlerat e



rishikuar zëvendësojnë ato të publikuara më parë.

Trump mesazh ndërmjetësuesve: Asnjë zhbllokim i aseteve iraniane para nënshkrimit të një draft-marrëveshjeje me Teheranin

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, e lidh lirimin e fondeve të ngrira iraniane të mbajtura jashtë vendit me nënshkrimin e një marrëveshjeje të përkohshme, sipas informacionit të cituar nga Al Arabiya/Al Hadath. Një burim me njohuri mbi negociatat tha se presidenti i SHBA-së i ka informuar ndërmjetësit se nuk do ta

miratojë lirimin e fondeve të ngrira iraniane përpara se të arrihet dhe nënshkruhet një marrëveshje me Teheranin. Sipas të njëjtut informacion, një nga pikat kryesore të mosmarrëveshjes mbetet mënyra se si menaxhohet një pjesë e fondeve të ngrira iraniane të mbajtura në bankat e huaja. Negociatorët po shqyrtojnë, ndër

të tjera, krijimin e një fondi të posaçëm në të cilin mund të transferohen këto fonde, në mënyrë që të ketë një mekanizëm për lirimin e tyre të kontrolluar. Në të njëjtën kohë, po vazhdojnë diskutimet se si një pjesë e parave mund të lirohet pa prishur procesin më të gjerë të negociatave.



SAMITI BE-BALLKANI PERËNDIMOR MË 5 QERSHOR, ZBARDHEN PIKAT KRYESORE TË AGJENDËS

Udhëheqësit e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor do të takohen në Tivat të Malit të Zi më 5 qershor. Samiti zhvillohet gjashtë muaj pas samitit të fundit në Bruksel, duke riafirmuar forcën e marrëdhënies së BE-së me Ballkanin Perëndimor.

Pikat kryesore të rendit të ditës

Samiti do të kryesohet nga Presidenti i Këshillit Evropian dhe do të drejtohet nga Presidenti i Malit të Zi. BE-ja do të përfaqësohet nga Presidenti i Këshillit Evropian dhe Presidenti i Komisionit Evropian. Përfaqësuesja e Lartë Kaja Kallas do të marrë pjesë gjithashtu.

Tema e samitit është " Prosperiteti dhe stabiliteti i përbashkët i BE-së dhe Ballkanit Perëndimor".

Gjatë drekës, udhëheqësit do të diskutojnë zgjerimin. Do të jetë një mundësi që BE-ja të përsërisë angazhimin e saj të plotë dhe të qartë ndaj perspektivës së anëtarësimit në BE të Ballkanit Perëndimor.

Pritet që udhëheqësit të vlerësojnë progresin e bërë në integrimin gradual të Ballkanit Perëndimor në BE dhe si ta çojnë atë më tej, veçanërisht përmes Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor.

Ata gjithashtu do të shqyrtojnë se si të adresohen sfidat e



përbashkëta dhe të forcohet siguria dhe qëndrueshmëria, në sfondin gjithnjë e më kompleks gjeopolitik.

Integrimi gradual dhe Plani i Rritjes

I lançuar në vitin 2023, Plani i Rritjes synon të inkurajojë konvergencën më të shpejtë socio-ekonomike me BE-në dhe integrimin gradual në tregun e vetëm të BE-së duke: rritja e integritimit ekonomik të partnerëve të Ballkanit Perëndimor në tregun e vetëm të BE-së

avancimin e bashkëpunimit ekonomik rajonal nëpërmjet Tregut të Përbashkët Rajonal duke nxitur reformat që lidhen me BE-në duke ofruar deri në 6 miliardë euro për reforma dhe investime BE-ja është partneri kryesor dhe më i besueshëm i Ballkanit Perëndimor. Është partneri kryesor tregtar, investitori dhe donatori i rajonit.

Forcimi i sigurisë dhe mbrojtjes

Në një kohë të rritjes së pasigurisë gjeopolitike dhe

paqëndrueshmërisë ekonomike, udhëheqësit pritet të diskutojnë se si të rrisin bashkëpunimin në çështjet e politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes:

në fushat e sigurisë dhe mbrojtjes, në veçanti duke forcuar forcat e armatosura të Ballkanit Perëndimor përmes Mekanizmit Evropian të Paqes dhe duke rritur bashkëpunimin përmes partneriteteve dhe dialogëve të sigurisë dhe mbrojtjes.

në ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj kërcënimeve kibernetike dhe kërcënimeve të tjera hibride, për

të luftuar manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit të huaj, duke përfshirë Agjencinë e BE-së për Sigurinë Kibernetike (ENISA), Mburoja Evropiane e Demokracisë dhe Sistemi i Alarmit të Shpejtë (RAS) kundër dezinformimit.

Midis 1 dhe 4 qershorit 2026, Presidenti Costa do të takohet me udhëheqësit rajonalë midis partnerëve të Ballkanit Perëndimor.

Ata do të diskutojnë mundësitë dhe sfidat që lidhen me zgjerimin, integrimin gradual, bashkëpunimin rajonal, sigurinë dhe stabilitetin.

Mori pjesë gjatë sulmit në Capitol, Trump e punëson në Pentagon, pakënaqësi në departament

Emërimi i Elias Irizarry në një post të ndjeshëm në Departamentin Amerikan të Mbrojtjes ka shkaktuar polemika brenda Pentagonit për shkak të përfshirjes së tij në trazirat e 6 janarit 2021 në Kapitol.

Ai do të punojë në zyrën për Operacionet Speciale dhe Konfliktet me Intensitet të Ulët, e cila merret edhe me shpëtimin e

pengjeve dhe rikuperimin e personelit. Në vitin 2023 ai u dënua me 14 ditë burg pasi hyri në Kapitol përmes një dritareje të thyer gjatë sulmit ndaj Kongresit.

Kritikët argumentojnë se ai nuk duhet të mbajë një detyrë që kërkon akses në informacione tepër sekrete dhe vënë në dyshim përvojën e tij

profesionale. Recently Spotted Asteroid Set for Near Miss With Earth Keep Watching Irizarry, i cili ishte 19 vjeç gjatë ngjarjeve të 6 janarit, u diplomua në akademinë ushtarake Citadel në vitin 2024 dhe më pas kandidoi pa sukses për një vend në legjislaturën e Karolinës së Jugut.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Xhaka dëshiron të bëhet kampion bote me Zvicrën

BERNË, 4 QERSHOR - Kapitani i Kombëtares së Zvicrës, Granit Xhaka, nuk i ka fshehur ambiciet e tij para Kupës së Botës që nis javën e ardhshme. Xhaka ka pranuar haptazi se ëndrra e tij është të shpallet kampion në Zvicrën, duke e ngritur trofeun e

madh të futbollit. Kjo deklaratë e tij për mediumet zvicerane, ka tërhequr vëmendje të madhe në prag të këtij turneu që do të mbahet në ShBA, Meksikë dhe Kanada. "Dua të bëhem kampion bote. Ndoshta disa do të qeshin me këtë, por unë

gjithmonë kam menduar në këtë mënyrë. Duhet të kesh vizion dhe të mendosh në përmasa të mëdha. Nëse nuk beson vetë në ëndrrat e tua, atëherë nuk mund t'i arrish kurrë ato", ka thënë Xhaka. Me pjesëmarrjen në këtë Botëror,

Xhaka barazon rekordin e Valon Behramit dhe Xherdan Shaqirit, të cilët kanë pasur katër paraqitje në këtë ngjarje të madhe. Zvicra bën pjesë në Grupin B, ku do të përballet me Katarin, Bosnjë-Hercegovinën dhe Kanadanë.



GJENERATA E RE E KOSOVËS NË XHUDO VAZHDON PËRGATITJET NË KAMPE NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Është mbajtur kampi ndërkombëtar stërvitor i xhudos në Graz të Austrisë. Xhudistët dhe xhudistet e ekipit të Kosovës kanë zhvilluar përgatitje intensive

për tri ditë, duke u stërvitur së bashku me sportistë nga vende të ndryshme të botës. Përgatitjet do të vazhdojnë në Slloveni dhe Kroaci si pjesë e programit të zhvillimit afatgjatë të

gjeneratës së re. Ekipi nga Kosova është duke punuar nën udhëheqjen e trajnerëve Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi, me synim ndërtimin e një gjenerate të fortë dhe të



suksesshme. Fokusi kryesor i kësaj gjenerate mbetet përgatitja për ciklin olimpiq 2028-2032 dhe përfaqësimi sa më dinjitoz i Kosovës në arenën ndërkombëtare.

CAS KONFIRMON VENDIMIN E FFK-së NË RASTIN E ANKESËS SË FC PRISHTINËS

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar se Gjykata e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë (Court of Arbitration for Sport - CAS) ka vendosur në favor të FFK-së në çështjen e iniciuar lidhur me vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv të Kosovës (GjAS) në rastin e FC Prishtina. "CAS ka vërtetuar si të drejtë vendimin e FFK-së për moslicencimin e FC Prishtina për edicionin garues 2023/24 për garat evropiane, duke i dhënë legjitimitet të plotë veprimeve të saj në përputhje me rregulloret në fuqi", ka njoftuar FFK.



Me këtë rast, CAS ka konfirmuar qartë se FFK-ja nuk i nënshtrohet juridiksionit të GjAS-it, duke konfirmuar në këtë mënyrë autonominë dhe pavarësinë e saj si organi më i lartë i futbollit në vend. Në pikën 186 të vendimit, Paneli ka theksuar që nga provat e paraqitura në seancë rezultojn

se nuk ka pasur kundërshtime lidhur me faktin që FC Prishtina ishte trajnuar për procesin e licencimit nga menaxheri i licencimit të FFK-së, Bajram Shala dhe ishte njoftuar qartë e me kohë se shkalla e tretë e ankesës ishte në CAS në Zvicër. Për më tepër, sipas FFK-së, klubi duhej të kishte marrë në konsideratë edhe statutin e FFK-së dhe Rregulloren e UEFA-s për licencimin e klubeve, i cili thekson se, në rast se një federatë anëtare ka të përcaktuar një tribunal arbitrazhi, atëherë është pikërisht ky organ që vendos mbi juridiksionin e sistemit të

licencimit të klubeve. Ndërsa më tej në vendim është saktësuar që Statuti i FFK-së përcakton organin kompetent për çështjet e licencimit në Nenin 58. Ndërkohë, interpretimi i kombinuar i Nenit 67.1 me Nenin 58, e bën të qartë se vendimet e Organit të Apelit për Licencim mund të kundërshtohen vetëm në CAS në Lozanë, sipas dispozitave statutores. Duke marrë parasysh edhe përkufizimin statutor të CAS-it me seli në Lozanë, rezultojn se organi kompetent ishte CAS-i në Zvicër dhe jo GjAS në Kosovë. Në përfundim të vendimit, Paneli

ka vlerësuar se GjAS-i nuk kishte juridiksion për ta shqyrtuar ankesën kundër vendimit të shkallës së dytë. "Ky vendim i CAS-it, përtej një fitoreje juridike, përbën një dëshmi të fuqishme të pozitës ndërkombëtare të FFK-së dhe të respektimit të standardeve të organizimit të futbollit sipas rregullave të FIFA-s dhe UEFA-s. Në thelb, CAS ka riafirmuar parimin se federatat kombëtare të futbollit gëzojnë autonomi të plotë në vendimmarrje dhe nuk mund t'u nënshtrohen ndërhyrjeve apo juridiksioneve të jashtme që cenojnë këtë pavarësi", ka njoftuar FFK-ja.

MBI NJË MIJË FËMIJË VRAPOJNË PËR DITËN OLIMPIKE NË PRISHTINË

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Në një atmosferë festive dhe të mbushur me entuziazëm fëmijësh, sheshi i Prishtinës është shndërruar në arenë kryesore të festimeve për Ditën Olimpikë. Mbi një mijë nxënës nga shkolla të ndryshme të kryeqytetit janë mbledhur për të shënuar këtë datë të rëndësishme globale të sportit, e cila është festuar më herët se data zyrtare e 23 qershorit, me qëllim që nxënësit të mund të merrnin pjesë para përfundimit

të vitit shkollor. Të pranishëm në këtë ngjarje masive ishin figura të larta të sportit, duke përfshirë presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës Ismet Krasniqi dhe drejtorin e Sportit në komunën e Prishtinës, Granit Geci. Gjatë fjalimit para të pranishmëve, presidenti i Komitetit Olimpik kujtoi rëndësinë e lidhjes mes sportit dhe arsimit, duke garantuar se aktiviteti fizik ndihmon në rritjen e përqendrimit në mësim dhe në zhvillimin e një jete të

shëndetshme. "Unë ju thërras të gjithë juve fëmijëve të dashur, shfrytëzoheni sa më shumë jetën tuaj të mirë me sport dhe me mësim. Këto të dyja lidhen shumë ngushtë njëra me tjetrën. Sporti ju ndihmon të keni trurin më të përqendruar në mësimet e juaja. Merruni me sport! Sepse kur merreni me sport, jeni më të aftë edhe për të mësuar, ju premtoj këtë. Pra merruni me sport që të jeni më të shëndetshëm, jeni më të fokusuar, dhe jeni më të mirë për

popullin tonë, për vendin tonë, për shtetin tonë", ka thënë Krasniqi. Ndërsa drejtori i Sportit në komunën e Prishtinës, Granit Geci, ka dhënë një mesazh për gjeneratat e reja, duke kërkuar nga ta që të largohen nga ekranet e telefonave dhe t'u përkushtohen aktiviteteve sportive. "Sot për juve kam vetëm një këshillë: merruni me aktivitete sportive, largohuni nga telefonat dhe rrituni të shëndetshëm ashtu siç tha edhe



presidenti më parë. Andaj ju lus të jeni të mirë, të shëndetshëm, merruni me aktivitete sportive dhe e ardhmja juaj është e ndritshme", ka thënë Geci.



Altin Gjokaj grumbullohet me Kombëtaren A

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Për shkak të shqetësimeve të ndiera gjatë stërvitjes është vendosur që portieri Arijanet Muriq të mos ngarkohet më tej, me qëllim që të shmanget çdo rrezik për

ndonjë lëndim eventual. Në pamundësi që ekipit t'i bashkohet portieri Faton Maloku, i cili ishte në listën rezervë, përzgjedhësi Franco Foda, ka vendosur ta ftojë

portierin e Kombëtares U21, Altin Gjokaj, i cili do t'i bashkohet Kombëtares A dhe do të jetë pjesë e saj deri në përfundim të këtij grumbullimi. Gjokaj konsiderohet një prej

portierëve më premtues të gjeneratës së re dhe kjo ftesë paraqet një mundësi të rëndësishme për të fituar përvojë pranë ekipit kombëtar A.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Kryeshefes Ekzekutive të datës 03.06.2026 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme njëmbëdhjetë (11) muaj, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 05.06.2026 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Katër (4) Punëtor Fizik- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 11/ njëmbëdhjetë muaj), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 03-06-253

Përgatitja profesionale: Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme

Lartësia e pagës mujore: 496.65 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Një (1) Vozitës i kategorisë "C"- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 11/ njëmbëdhjetë muaj), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 03-06-253

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 542.89 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhërësen e Punës në të cilën evidencën punët e kryera ,vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letrën e re të tahograftit ndërsa letrën paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letrën e tahograftit ka obligim që në të të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon,largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidencën në urdhërësen e punës;
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtëpërdrejtë dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtëpërdrejtë;
- Vozitësi e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit drejtëpërdrejtë, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimi me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatë fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendarit i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejtë të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 05.06.2026 deri me 19.06.2026, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e pakompletuara, si dhe aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar në shpallje, nuk do të shqyrtohen.



Prishtinë, 03.06.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 81050100 me adresë: Rr. „Adem Jashari“, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.05.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **0.57 MW** ZK Prekallë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Elektro System“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **0.57 MW** ZK Prekallë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.6336-2/25 dt. 03.12.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore nr. 11-351-40062/145 dt. 21.11.2026 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimi për Leje Ndërtimore Nr. 11-351-45958/158 dt. 30.12.2025 për "Instalimin e Sistemit Solar Fotovoltaik- me kapacitet 0.57 MW, ngastrata katastrale 00371-6, dhe 00371-7 ZK Prekallë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 5723 dt. 22.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: elektrosystem16@gmail.com dhe LEGAL-LECEENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besart Brahimi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m.l.t. "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjuraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.

- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U "Engjëll Gjoni", Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

